



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM
Nr. 584, datë 18.10.2023
PËR

**PËRFUNDIMIN E AFATIT TË KOMANDIMIT SI INSPEKTORE NË ZYRËN E
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, PËR MAGJISTRATEN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 57 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimet e tij nr. 333 datë 17.09.2020 “Për Zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}” dhe nr. 583 datë 18.10.2023 “Mbi ngritjen në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të znj. {...}”, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e afatit të komandimit si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...} më datë 30.11.2023.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistrates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR